

## **Pozicion pune në projektin “Qendër Multifunksionale Ditore për të Moshuarit”**

### **PERSHKRIMI I PROJEKTIT:**

Projekti “Qendrës Multifunksionale Ditore për të Moshuarit” përfshin punën individuale me të moshuarit si dhe punën me komunitetin për informimin dhe angazhimin e tyre në aktivitete të ndryshme. Ai mbulon një gamë të gjerë ndërhyrjesh duke përfshirë terapi individuale, punë në grup, fizioterapi, mbështetje psikologjike dhe shëndetësore, si dhe aktivitete fizike dhe relaksuese. Këto shërbime do të ofrohen në katër ambiente të ndryshme, vendodhja e të cilave do të jetë në lagje të ndryshme të qytetit.

### **2.OBJEKTIVI DHE QËLLIMI**

#### **2.1 Objektivi**

- ✓ Hapja e katër qendrave ditore për të moshuarit në Elbasan.
- ✓ Të sigurojë një ambjent mbështetës dhe të sigurtë për të moshuarit, ku ata mund të përfitojnë nga shërbime të ndryshme shëndetësore, psikologjike dhe sociale.
- ✓ T’i ndihmojë ato të ruajnë shëndetin fizik dhe emocional, të rrisin cilësinë e jetesës dhe të inkurajojnë socializimin dhe aktivitete të përbashkëta.

#### **2.2 Qëllimi**

- ✓ Mbështetje /asistencë psikologjike;
- ✓ Fizioterapi;
- ✓ Mbështetje shëndetësore;
- ✓ Asistencë shëndetsore;

### **3. DETYRAT E CAKTUARA**

Objektivat që duhen të plotësohen nga pozicionet Psikolog, Punonjës Social, Fizioterapist, Infermier, Operator Social, si dhe Koordinator Projektit do të ndahen në detyra dhe përgjegjësi. Më poshtë pasqyrohen detyrat dhe përgjegjësitë sipas pozicionit:

#### **3.1 Psikologu**

Pozicioni i Psikologut do të luajë një rol kyç në ofrimin e mbështetjes psikologjike dhe emocionale për individët dhe grupet e synuara nga programi/projekti. Do të jetë përgjegjës për vlerësimin, këshillimin dhe zhvillimin e ndërhyrjeve për të përmirësuar mirëqenien psikologjike të përfituesve, duke punuar në përputhje me standardet etike dhe profesionale.

- ✓ Kryerja e vlerësimeve psikologjike për të identifikuar nevojat dhe sfidat e përfituesve.
- ✓ Ofrimi i këshillimit individual dhe në grup për përmirësimin e shëndetit mendor dhe mirëqenies emocionale.
- ✓ Hartimi dhe zbatimi i programeve psiko-edukative dhe ndërhyrjeve të përshtatura sipas nevojave të përfituesve.

- ✓ Bashkëpunimi me ekipin multidisiplinar për të siguruar një qasje të integruar dhe efektive në mbështetje të individëve.
- ✓ Ofrimi i mbështetjes psikologjike për grupet ne nevojë përfshirë moshën e tretë .
- ✓ Monitorimi dhe vlerësimi i progresit të përfituesve dhe dokumentimi i rasteve në përputhje me rregullat e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave.
- ✓ Organizimi i trajnimeve dhe seminareve për rritjen e ndërgjegjësimit mbi shëndetin mendor dhe përmirësimin e aftësive përballuese të përfituesve.
- ✓ Ofrimi i rekomandimeve dhe këshillave për institucionet dhe organizatat partnere mbi praktikat më të mira në fushën e shëndetit mendor.

### **3.2 Fizioterapist**

Pozicioni i Fizioterapisti do të jetë përgjegjës për ofrimin e shërbimeve terapeutike për të ndihmuar pacientët/ përfituesit të përmirësojnë ose rikuperojnë funksionet fizike, duke përdorur teknika të ndryshme rehabilituese. Do të punojë ngushtë me individët për të zhvilluar plane të personalizuara të trajtimit dhe për të promovuar një jetë aktive dhe të shëndetshme.

Kryerja e vlerësimeve fizike dhe funksionale për të përcaktuar nevojat dhe aftësitë e pacientëve.

- ✓ Hartimi dhe zbatimi i planeve individuale të rehabilitimit për të përmirësuar lëvizshmërinë, forcën dhe mirëqenien fizike të përfituesve.
- ✓ Aplikimi i metodave dhe teknikave të ndryshme fizioterapeutike, duke përfshirë terapi manuale, ushtrime terapeutike dhe pajisje të specializuara.
- ✓ Edukimi i pacientëve mbi praktikat më të mira për parandalimin e dëmtimeve dhe menaxhimin e dhimbjeve kronike.
- ✓ Monitorimi i progresit të pacientëve dhe përshtatja e trajtimeve sipas nevojës për të maksimizuar rezultatet.
- ✓ Bashkëpunimi me profesionistë të tjerë të shëndetit, përfshirë mjekë dhe specialistë të rehabilitimit, për të ofruar një trajtim të integruar.
- ✓ Ofrimi i rekomandimeve për kujdesin e mëtejshëm dhe ushtrimet që pacientët mund të kryejnë në mënyrë të pavarur.
- ✓ Respektimi i protokolleve dhe standardeve të sigurisë dhe etikës profesionale në punën e përditshme.

### **3.3 Punonjës Social**

Pozicioni i punës i Punonjësi social do të jetë përgjegjës për ofrimin e mbështetjes dhe shërbimeve sociale për individët dhe familjet në nevojë, me fokus në përmirësimin e mirëqenies së tyre dhe fuqizimin e tyre për të përballuar sfidat sociale. Do të punojë për të identifikuar problemet sociale,

për të ndërmjetësuar në ofrimin e ndihmës së duhur dhe për të koordinuar shërbimet me institucionet dhe organizatat përkatëse.

- ✓ Vlerësimi i nevojave sociale dhe ekonomike të individëve dhe familjeve në nevojë.
- ✓ Ofrimi i këshillimit social dhe psikologjik për përmirësimin e mirëqenies së përfituesve.
- ✓ Hartimi dhe zbatimi i planeve individuale të ndërhyrjes për adresimin e sfidave sociale.
- ✓ Ndërmjetësimi dhe referimi i rasteve në institucionet dhe organizatat përkatëse për të siguruar ndihmën e nevojshme.
- ✓ Bashkëpunimi me institucione publike dhe organizata joqeveritare për të siguruar akses në shërbimet sociale dhe për të promovuar integrimin social.
- ✓ Ofrimi i mbështetjes për grupet vulnerabël për të përmirësuar cilësinë e jetës së tyre përfshi moshën e tretë .
- ✓ Organizimi i aktiviteteve dhe fushatave ndërgjegjësuere për çështje sociale si mbrojtja e të drejtave të njeriut, barazia gjinore, edukimi dhe integrimi social.
- ✓ Dokumentimi i rasteve dhe mbajtja e regjistrave sipas standardeve të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave.
- ✓ Monitorimi dhe vlerësimi i impaktit të ndërhyrjeve sociale dhe ofrimi i rekomandimeve për përmirësimin e shërbimeve.

### **3.4 Operator Social**

Pozicioni i punës Operatori social do të jetë përgjegjës për ofrimin e shërbimeve të asistencës dhe mbështetjes për individët dhe familjet në nevojë, duke vepruar si një pikë kontakti për të siguruar aksesin në shërbime sociale. Do të luajë një rol kyç në orientimin, informimin dhe mbështetjen e përfituesve për të përmirësuar cilësinë e jetës së tyre.

- ✓ Ofrimi i informacionit dhe orientimi i përfituesve për shërbimet sociale dhe mundësitë e asistencës.
- ✓ Regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave për përfituesit dhe nevojat e tyre sociale.
- ✓ Bashkëpunimi me punonjësit socialë dhe institucionet përkatëse për të siguruar mbështetje të integruar për përfituesit.
- ✓ Ofrimi i ndihmës praktike dhe logjistike për individët në nevojë, përfshirë ndihmë në aplikimin për shërbime dhe mbështetje.
- ✓ Organizimi dhe ndjekja e aktiviteteve sociale dhe komunitare për të promovuar integrimin dhe mirëqenien e përfituesve.
- ✓ Mbështetja e përfituesve në zhvillimin e aftësive të tyre për të përmirësuar pavarësinë dhe përfshirjen sociale.

- ✓ Sigurimi i një komunikimi të vazhdueshëm me përfituesit për të identifikuar sfidat e tyre dhe për të përcaktuar masat e duhura të mbështetjes.
- ✓ Respektimi i parimeve etike dhe konfidencialitetit në trajtimin e informacionit të përfituesve.

### **3.5 Infermier**

Pozicioni i punës Infermier do të ofrojë kujdes shëndetësor dhe mbështetje për të moshuarit dhe grupet vulnerabël, duke siguruar një shërbim cilësor të përshtatur sipas nevojave të tyre. Ai/ajo do të ndihmojë në monitorimin e shëndetit, administrimin e medikamenteve dhe edukimin shëndetësor, duke luajtur një rol kyç në përmirësimin e cilësisë së jetës së përfituesve.

- ✓ Monitorimi i gjendjes shëndetësore të pacientëve dhe vlerësimi i nevojave të tyre.
- ✓ Administrimi i medikamenteve sipas udhëzimeve mjekësore dhe mbajtja e dokumentacionit përkatës.
- ✓ Kryerja e procedurave infermiore bazë si matja e tensionit, kontrolli i nivelit të sheqerit në gjak, ndihma në lëvizshmëri, etj.
- ✓ Edukimi i pacientëve dhe familjarëve mbi kujdesin shëndetësor, higjienën dhe ushqyerjen e shëndetshme.
- ✓ Ofrimi i mbështetjes emocionale dhe psikologjike për të moshuarit dhe individët nga grupet vulnerabël.
- ✓ Bashkëpunimi me mjekë dhe profesionistë të tjerë të kujdesit shëndetësor për të siguruar një trajtim të integruar.
- ✓ Menaxhimi i rasteve emergjente dhe ofrimi i ndihmës së parë kur është e nevojshme.
- ✓ Sigurimi i një ambienti të sigurt dhe të përshtatshëm për pacientët, duke respektuar standardet dhe protokollat e kujdesit shëndetësor.

### **3.6 Koordinator projekti**

Për pozicionin e punës Koordinatori i projektit do të jetë përgjegjës për menaxhimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të qendrave për moshën e tretë, duke siguruar ofrimin e shërbimeve cilësore për të moshuarit dhe përmirësimin e mirëqenies së tyre. Ai/ajo do të mbikëqyrë zbatimin e projekteve, do të koordinojë me stafin dhe institucionet përkatëse dhe do të sigurojë që programet të jenë të përshtatura me nevojat e përfituesve.

- ✓ Hartimi, zbatimi dhe monitorimi i projekteve për menaxhimin e qendrave të moshës së tretë.
- ✓ Koordinimi i stafit të qendrës, përfshirë punonjësit socialë, infermierët dhe vullnetarët, për të siguruar një shërbim të integruar.
- ✓ Sigurimi i ofrimit të aktiviteteve sociale, shëndetësore dhe kulturore për përmirësimin e cilësisë së jetës së të moshuarve.
- ✓ Bashkëpunimi me institucionet publike dhe organizatat joqeveritare për të forcuar mbështetjen për qendrat dhe përfituesit.
- ✓ Monitorimi dhe vlerësimi i progresit të projekteve dhe hartimi i raporteve për donatorët dhe partnerët.
- ✓ Administrimi i burimeve financiare dhe materiale të qendrës, duke siguruar përdorimin e tyre të efektshëm.

- ✓ Organizimi i fushatave ndërgjegjësuere dhe aktiviteteve komunitare për të promovuar përfshirjen sociale të të moshuarve.
- ✓ Trajtimi i sfidave dhe gjetja e zgjidhjeve për të përmirësuar shërbimet dhe funksionimin e qendrës.
- ✓ Mbikëqyrja e respektimit të standardeve dhe protokolleve për kujdesin ndaj të moshuarve.

#### 4. KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e kontratës do të jetë deri në përfundim të projektit.

#### 5. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

1. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <https://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
2. Diplomë e listë notash të noterizuar (përfshirë edhe diplomën bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit.
3. Fotokopje të letërnjoftimit (ID)
4. Dëshmi penaliteti
5. Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria që nuk është në ndjekje penale
6. Raport mjekësor që vërteton se është i aftë për punë
7. Fotokopje të certifikatave të trajnimit (nese ka)
8. Letër reference nga punëdhënësi i mëparshëm (nëse ka)
9. Letër motivimi ku kandidati/ja të shprehë të qartë pozicionin për të cilin po aplikon:
10. Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet e aplikimit deri më date 17.03.2025 në adresën: Drejtoria e Administraës dhe Burimeve Njerëzore, Bashkia Elbasan.

#### 6. KRITERET E PËRZGJEDHJES

Pjesëmarrja është e hapur për të gjithë personat që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

##### Kualifikimet dhe aftësitë

- ✓ Aftësi shumë të mira koordinuese, organizative dhe komunikuese për të punuar në një projekt
- ✓ Aftësi shumë të mira për të menaxhuar dhe kryer disa punë në të njëjtën kohë.
- ✓ Përvoja të mëparshme në detyra të ngjashme.
- ✓ Aftësia për të prioritetizuar dhe menaxhuar kohën në mënyrë efektive.
- ✓ Aftësi të shkëlqyera komunikimi verbale dhe të shkruara
- ✓ Aftësi për të identifikuar dhe menaxhuar rreziqet.
- ✓ Njohuri të mira në procedurat administrative të shtetit.
- ✓ Aftësi për të punuar në një mjedis dinamik dhe për të menaxhuar situata sfiduese.

##### Eksperienca profesionale

##### **Për pozicionin e punës Psikolog**

- ✓ **Edukimi:** Diplomë universitare në Psikologji (Master i Shkencave në Psikologji Klinike, Psikologji Shkollore ose fusha të ngjashme).
- ✓ **Eksperienca:** Eksperiençë e mëparshme në këshillim psikologjik dhe mbështetje psiko-sociale, preferohet përvoja me grupe vunerabël.

### **Për pozicionin e punës Fizioterapist**

- ✓ **Edukimi:** Diplomë universitare Bachelor/master në Fizioterapi
- ✓ **Eksperiencia:** Preferohet përvoja në rehabilitimin e pacitëve me dëmtime muskulore , ortopedike apo neurologjike

### **Për pozicionin e punës Punonjës Social**

- ✓ **Edukimi:** Diplomë universitare në Punë Sociale, Sociologji , Psikologji ose fusha të ngjashme
- ✓ **Eksperiencia:** ofrimin e shërbimeve sociale dhe mbështetje për grupet në nevojë.

### **Për pozicionin e punës Operator Social**

- ✓ **Edukimi:** Diplomë universitare në Punë Sociale, Sociologji , Psikologji ose fusha të ngjashme ose arsim të mesëm me përvojë në fushën sociale, educative ose komunitare.
- ✓ **Eksperiencia:** njohuri në ofrimin e shërbimeve sociale dhe mbështetje për grupet në nevojë.

### **Për pozicionin e punës Infermier**

- ✓ **Edukimi:** Diplomë universitare në Infermieri dhe licencë e vlefshme për ushtrimin e profesionit
- ✓ **Eksperiencia:** njohuri në kujdesin shëndetësor për të moshuarit dhe grupet vunerabë.

### **Për pozicionin e punës Koordinator i Projektit**

- ✓ **Edukimi:** Diplomë universitare në Menaxhim, Administrim Biznes, Shkenca Sociale , Punë Sociale ose fusha të ngjashme.
- ✓ **Eksperiencia:** Menaxhim të projekteve

Kandidatët të cilët do të aplikojnë për këto pozicione pune do t'i nënshtrohen dhe intervistës me gojë e vlefshme për procesin e vlerësimit .